



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 91/13
Prishtinë, më 30.01.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama.

Munguan: Naser Osmani, Duda Balje, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Rrahman Paçrizi Kryetar i Bordit të RTK-së, Mentor Shala, Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së, Bujar Spahiu Drejtor i Financiar i RTK-së, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt.23.01.2013**
- 3. Shqyrtimi i Projektioneve të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2013**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja theksoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt. 23.01.2013**

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

- 3. Shqyrtimi i Projektioneve të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2013**

Kryetarja theksoi se ligji që është miratuar për Radiotelevizionin e Kosovës e ka paraparë që për një kohë të jenë 0,7 % e buxhetit për Radiotelevizionin, në bazë të këtij proporcioni edhe janë ndarë mjetet. Në komision është marrë një vendim që Radiotelevizioni t'ia paraqet kërkesën buxhetore të detalizuar Kuvendit, poashtu ti raportoj edhe më tutje në periudha të caktuara kohore. E kemi marr një plan ashtu siç e kanë paraparë shpenzimin e mjeteve. Është paraparë që të hyrat e buxhetit të jenë 8,561,000, ndërkaq të hyrat vetanake janë nga marketingu 1,500,000, kurse të hyrat e tjera janë 200,000. Në tota; buxheti i RTK-së për vitin 2013 është 10,261,000.

Rrahman Paçarizi sqaroi se është fillimi i muajit dhe RTK-ja është në situatë të tillë që nuk do të mund të realizoj pagesat për punëtorët për pagat e muajit janar. Bordi e ka miratuar këtë si plan të shpenzimeve ndërsa plani financiar i RTK-së do të miratohet në mbledhjet e ardhshme të bordit. Ne kemi kërkuar nga menaxhmenti një plan më të detajuar, ky është plani i të hyrave dhe shpenzimeve, i cili shpresojmë të jetë i mjaftueshëm për komisionin tuaj që të miratoj derdhjen e mjeteve për realizimin e pagave për funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Latif Gashi jam dakord me propozimin e kryetares, që të shqyrtojmë në Komision dhe të rekomandojmë që raportimi dhe planifikimi të jetë për çdo gjashtë muaj. Sa i përket këtij projekcionit konsideroj që duhet ta aprovojmë kurse herëve të tjera do të ishte mirë të ia bashkangjesim pjesës tabelare edhe pjesën e saj tekstuale.

Xhevdet Neziraj do të ishte mirë të kemi ndonjë raport më të detalizuar të paraqitjes së shpenzimeve, prezantimit të të dhënave në formë më analitike që të mund të bëjmë krahasimet e nevojshme. Po ashtu nuk kemi të dhëna për borxhin e RTK-së. Sa i përket politikës redaktuese nuk jam i kënaqur si pjesëtarë i komunitetit egjiptian, pasi që ky komunitet nuk pasqyrohet dhe pasqyrohet sa duhet në emisionet e këtij mediumi publik.

Hykmete Bajrami konstatoj se janë raportet më joprofesionale që vijnë nga RTK-ja. Në çdo planifikim buxhetor duhet të dihet se çka po ndodh me borxhet e RTK-së, pasi që si anëtare e komisionit në fundvit kam pasur telefonata se RTK-ja ka probleme me pagat e dhjetorit, nuk e di se çka ka ndodh me ato paga? Borxheve të akumuluar duhet ti gjindet një zgjidhje dhe çështja është ngrit disa herë duke pas parasysh se borgji nëse lihet dhe grumbullohet skemi bërë asgjë. Kam dëgjuar prej Kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, që raporti i auditorit cilëson shumë të gjetura, të cilat nuk duhet të përkohet me punën dhe profesionalizmin e RTK-së.

Kryetarja theksoi se në vazhdimësi e kemi shpreh shqetësimet lidhje me mënyrën e raportimit dhe planifikimit të Radiotelevizionit të Kosovës. Megjithatë plotësimi i bordit po bëhet dhe duhet të merret parasysh se transparenca tek financat duhet të ekzistojë. Për ne janë të panjohura shpenzimet e kompanisë në emër të kontributeve dhe në emër të sigurimit prandaj duhet të pasqyrohen më detalisht sesi janë shkuar shpenzimet për vitin 2012. Poashtu tërhoqi vërejtjen në lidhje me pozicionin programi ku shkojnë pjesa më e madhe e mjeteve por edhe për pozicionin e pagave është mirë të jepni shënime më të detalizuara. Vitin e kaluar kemi rekomanduar që Auditori i Përgjithshëm të bëjë auditimin e RTK-së, shpresoj që ky raport i auditimit së bashku me raportin e punës do të vij në të njëjtën kohë në mënyrë që ne si deputet të kemi mundësi të marrim vendim në bazë të asaj që paraqet performancën e shpenzimit të mjeteve, që është raporti i auditimit, mënyrën e shpërndarjes së mjeteve që na vie neve si komision dhe komisioni tjetër të merr vendimet veta në lidhje me efektshmërinë e punës jashtë çështjes së financave.

Hykmete Bajrami edhe mua më intereson të kemi sqarime se qfarë janë shpenzimet e kompanisë në emër të kontributeve, nëse është kontributi në fond pensional kjo nuk duhet të ndahet nga pagat, duhet të jenë në të njëjtin zë.

Bujar Spahiu sqaroi se RTK-ja nuk është organizatë buxhetore dhe ky fakt është mosmarrëveshja më e madhe e punës së raportimit. RTK-ja ka status të ndërrmarjës publike, e cila nuk punon në bazë të sistemit të frreebalancit por funksionin në bazë të sistemit të financave të kontabilitetit të dyfisht ku secila ngjarje regjistrohet, pasi që kur ndodh diçka regjistrohet. RTK gjatë vitit ka dy auditime: Auditimin e jashtëm të pavarur, të cilin është e obliguar ta paguajë vet dhe auditimin nga ana e auditorit të përgjithshëm. Shpenzimet e kompanisë në emër të kontributeve në bazë të ligjit janë të obliguar që 5% të kontributit e paguan ndërrmarja, dhe 5% punëtori prej pagës së tij. Sa i përket mënyrës së raportimit nga një ish anëtar i këtij komisioni është kërkuar të ketë një raport të shkurtër të raportimit, të të hyrave dhe shpenzimeve.

Kryetarja sqaroi se është e vërtetë se RTK-ja është ndërrmarje publike por në këtë rast po bën përjashtime nga të gjitha rastet e të gjitha vendeve se ndërrmarja publike nuk financohet direkt prej buxhetit të Republikës së Kosovës dhe meqenëse po financohet prej buxhetit të Republikës së Kosovës, atëherë ne si komision kemi marr vendim që ju të ngrakoheni me obligimet që ti raportoni komisionit dhe ne meqenëse janë tërësisht mjete të buxhetit e kemi një lloj mbikëqyrje në lidhje me shpenzimet e juaja.

Latif Gashi duke pas parasysh se këtu e kemi një projeksion dhe jo një raport pune, do të ishte mirë të hapet debati kur të jetë raporti i punës dhe i auditimit. Megjithatë z. Drejtor i Financave, ju e dini sa keni buxhet dhe shpenzimet duhet të bëhen atëherë sa keni të hyra dhe jo të veprohet ashtu siq është vepruar në të kaluarën, pasi që borgjet nuk e dijmë se si janë krijuar, a janë krijuar si rezultat i mosinkasimit të të hyrave përmes Kek-ut apo si rezultat i keqplanifikimit. Poashtu programet të mos blihen por të prodhohen, në bazë të ligjit e keni të specifikuar sesa duhet të blihet.

Mentor Shala sqaroi se ka qenë pjesë e menagjmentit pavarësisht se nuk ka pasur kompetenca për vendimmarrje, por e di sesi është menagjuar me RTK-në. Deklaroi se herave të tjera do të bëjmë një raport më të detajuar dhe më narrativ me tekst për secilën pikë veçmas, nuk do të jetë vetëm raport sipërfaqësor. Poshtu shpresoj se kur të vie raporti i punës të diskutohet për punën e borxheve sesi kanë ardhur ato borgje, këto janë çështje që auditori i përgjithshëm do ti nxjerr në sipërfaqe.

Kryetarja meqenëse kemi pas problem lidhur me atë se raportet kanë ardhur shumë shpejt për ti miratuar në çdo tre muaj, nëse pajtohen anëtarët e komisionit propozoj që për çdo gjashtë muaj të sillni një raport dhe plan të detalizuar në mënyrë që të kemi mundësi të merremi më detalisht dhe të diskutojmë.

Xhevdet Neziraj pajtohet me mendimin e kryetarës dhe si komision nuk jemi të interesuar askënd ta lëm pa pagë dhe kemi përgjegjësi ndaj kolegëve të grupeve tjera.

Pas diskutimeve, Komisioni me gjashtë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Kundër, nxori këtë.

Rekomandim

1. Komisioni përkrahu projektsionet e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2013, në shumën prej 10,261,000 Euro.
2. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 janar – 31 mars 2013, në shumën prej 2,140,250 Euro.
3. Radiotelevizioni i Kosovës deri më 31 mars 2013, të dorëzojë në Kuvend, planin e shpenzimeve të RTK-së për periudhën 1 prill – 30 qershor 2013, në bazë të së cilit Administrata e Kuvendit transferon mjetet buxhetore për atë periudhë buxhetore, në vlerë prej 2,140,250 Euro.

Mbledhja përfundoi: 13:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj